



DeckRefresh

KUJDESI I FSHIRJES



Pastron dhe mbron dyshemenë me një të fshirë!

Kujdes me anën e larjes me bazë uji për ambiente të jashtme. Substancë për larje me faktor për mbrojtjen e mjedisit: LOBA DeckRefresh e bën dyshemenë e verandës tuaj që të shkëlqejë përsëri si mëndafsh dhe bazohet vetëm në substanca të pastra natyrore. Kura jonë e freskisë për vendin tuaj më të dashur – në harmoni me natyrën!

- Kujdes fshirje i plotë, i butë
- I jep sipërfaqes një shkëlqim të mëndafshtë
- Përpunimi i shpejtë dhe i sigurt
- Nuk është i nevojshëm një pastrim themelor për shkak të një recete vetë-emulsifikuese
- E përshtatshme për sipërfaqe druri të vajosura dhe të llakuara në ambient të jashtëm

Gama e përdorimit:

E përshtatshme për kujdesin kundrejt dyshemeve prej druri të lyera me vaj ose me llak në ambiente të jashtme.

Të dhëna teknike të produkteve

NR. ARTIKULLI			
10711	2,5l	6	144

Vlera pH	7,2
Përbërësit	< 5% lëndë aktive anionike, LIMONENE, aroma, SODIUM PYRITHIONE, METHYLCHLOROISOTHIAZOLINONE AND METHYLISOTHIAZOLINONE (3:1), BENZISOTHIAZOLINONE
Magazinimi dhe transportimi	36 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit. Material i parrezikshëm sipas ADR. Depozitim dhe transportim në temperatura +5°C deri +25°C. Mbrojeni nga ngrica.
GISCODE	GU40

Udhëzime përpunimi

- Largojini papastërtitë e lira dhe pluhurin më parë me fshesë me korrent, fshesë ose pastrues dyshemeje.
- Kini parasysht rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në www.wingis-online.de.
- Tundni mirë materialin.

HOLLUES

Ujë.

MJET APLIKIMI / NORMË APLIKIMI

Pastrues dyshemeje LOBATOOL. Për pastrimin, kujdesin e përditshëm, hidhni rreth 50ml - 1l në një kovë me 10l ujë.

KOHA E THARJES

- rreth 30 min.

Kujdesi me anën e larjes:

Për pastrimin dhe kujdesin javor hidhni rreth 50-100 ml LOBA DeckRefresh në 10l ujë. Lajeni verandën me ndihmën e LOBA Wischmopp dhe të tretësirës pastruese. Lagështinë e mbetur lëreni që të thahet.

Kujdesi:

Hiqini në mënyrë mekanike papastërtitë e lira. Pastrojeni sipërfaqen me LOBA DeckCleaner në përputhje me informacionin teknik. 1l Hidhni LOBA DeckRefresh në 10l ujë dhe lajeni me një pastrues dyshemeje LOBA në mënyrë të njëtrajtshme sipërfaqen. Gjatë tharjes, mos shkelni mbi sipërfaqe.

Këshillë për verandat e konsumuara shumë:

LOBA DeckRefresh është e përshtatshme vetëm për verandat prej druri me shtresë llaku/imprenjim me vaj në përgjithësi të rregullt dhe duhet konsideruar vetëm për rifreskimin ndërmjet cikleve vjetore të riparimit. Për llakimin bazik, ose imprenjimin e mëvonshëm në këshillojmë LOBA DeckOil, ose LOBA DeckFinish Color.

Udhëzime të përgjithshme

Koha e tharjes: Kohët e dhëna të tharjes vlejné në +20°C dhe në 50% lagështirë ajri relative. Temperaturat më të ulëta, lagështia relative më e lartë e ajrit shkakton vonesa të tharjes. Para arritjes së fortësisë finale mos pastroni me leckë të lagur. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

Pastrimi i mjeteve të punës: Pastroni mjetet e punës me ujë menjëherë pas përdorimit.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speziale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve. Detyrimet dhe përgjegjësia jonë përcaktohet ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

Fjalët dhe simbolet me shenjë © përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.